



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
REKTORI

Nr. 1085 Prot.

Tiranë, më 09/05/2022

URDHËR

Nr. 43, datë 09.05.2022

PËR

**SHTYRJEN E PERIUDHËS SË APLIKIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruar nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës, Neni 5, në zbatim të Urdhërave të MAS, Nr. 175, Nr. 176, Nr. 177, Nr. 178, Nr. 179, Nr. 180, Nr. 181, Nr. 182, Nr. 183, datë 04.04.2022, mbështetur në kërkesën e njëjësive kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe me dakortësinë e anëtarëve të Senatit Akademik të UPT-së në mbledhjen e datës 28.04.2022,

URDHËROJ:

Shtyrjen e periudhës së aplikimeve deri më datë 27.05.2022, në programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” si më poshtë:

1. Doktoratë në “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit”, nënfusha “Inxhinieri Informatike” dhe nënfusha “Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni” - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit,
2. Doktoratë në “Inxhinieri Fizike” - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike,
3. Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Automatizimi i Industrisë” - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike,



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
REKTORI

4. Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Energjistikë” - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike,
5. Doktoratë në “Inxhinieri Ndërtimi”, nënfusha “Inxhinieri Mjedisi” – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit,
6. Doktoratë në “Gjeodezi” - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit,
7. Doktoratë në “Gjeologjia dhe Mjedisi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave,
8. Doktoratë në “Inxhinieri Naftë dhe Gazi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave,
9. Doktoratë në “Konstruksione mekanike dhe vlerësimi i integritetit strukturor” – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

REKTORI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

